



Datës-lizime 17/68 - Datë 17.05.2022  
Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.21.04.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana, Nazlije Shala dhe Linda Sadiku

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i shpenzimeve Janar-Mars 2022
4. Shqyrtimi i Draft Rregullore për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i Draft Rregullore nr.-I-36, të dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit
6. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 4 vota për dhe 2 vota abstenim.

### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 4 vota për dhe 3 vota kundër.

### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për raportin e shpenzimeve Janar – Mars 2022.

**Enver Gashi** – Ne jemi të pajtimit me këtë raport të DEFZH-së.

**Sami Ahmeti** – Realisht ne jemi që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend edhe pse ne shohim se është një raport i përgjithshëm, do të thotë nuk ka specifikime të mjaftueshme, mirëpo këto do ti bisedojmë në Kuvend.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa**, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal raportin e shpenzimeve Janar – Mars 2022.

### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e Draft Rregullore për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore të shkoj në Kuvend. Ne e kemi pasë edhe një Rregullore më heret, por MAPL-ja nuk e ka aprovue. Tash në Rregullore shkruan se do të bëhet një përmirësim, duhet të formohet Komisioni prej 5 anëtarëve, 3 duhet të jenë nga Kuvendi dhe 2 nga Ekzekutivi,

kështu që në Kuvend debatojmë. Besoj se kësaj here do të kaloj kjo Rregullore sepse është në të mirën e qytetarëve të Obiliqit dhe po kthehem në anën tjetër si qytetar pse ne mos me shfrytëzue këtë subvencion që na takon.

**Sami Ahmeti** – Realisht edhe ne jemi ku është me u bë kjo punë që qytetarët me pasë tarifa më të ulëta të energjisë elektrike dhe të gjërave tjera. Mirëpo, bazuar në Ligjin për Obiliqin, neni 8, pika 2, këtë kompetencë e ka Qeveria e Republikës bashkë me ZRRE-në. Ne jemi që kjo Draft Rregullore të shkoj në Kuvend, me bisedue dhe me nxjerrë më të mirën e mundshme. Megjithatë, nuk po duket se kemi me pasë sukses sikurse që s’kemi pasë sukses edhe herën e kaluar. Unë nuk e di sa janë bërë ndryshimet bazuar në tendencën e parë që është bërë, megjithatë unë konsideroj se prapë do të kthehet si jo e ligjshme. Mirëpo, sido që të jetë ne jemi që të shkoj në Kuvend dhe me nxjerrë më të mirën e mundshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Draft Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e Draft Rregullores nr.-I-36, të dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore të shkoj në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e Draft Rregullores nr.-I-36, të dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

**Enver Gashi** – Edhe për këtë Draft Rregullore jemi për dhënien e saj në debat publik, pastaj e votojmë në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi për.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti këto kërkesa:

1. Kërkesa nga Arben Krasniqi, i cili propozon që busti i heroit të Kosovës, "Fahri Fazliu" të zëvendësohet me shtatoren e tij.

Kjo kërkesë i dërgohet për shqyrtim DKRS-së, e cila duhet të sjellë një rekomandim në Kuvend.

2. Kërkesa nga Besnik Mjeku, i cili kërkon ndihmë financiare për FC "KEK-u.

Kjo kërkesë i dërgohet për shqyrtim DKRS-së, e cila duhet të sjellë një rekomandim në Kuvend.

**Enver Gashi** – Ne edhe në takimet e mëhershme të Komitetit jemi marrë vesh që të gjitha kërkesat që vijnë në Kuvend, natyrisht që është dashtë të shkojnë në Drejtoritë përkatëse, e jo te ne por popullata mendon se Kuvendi e rregullon. Mendoj se këto kërkesa duhet të iu dërgohen Drejtorive përkatëse, të cilat na rekomandojnë neve, pastaj ne mund të debatojmë dhe votojmë.

3. Kërkesa nga Irfan Hashani, nga Këshilli i bashkësisë islame që xhamitë të cilat figurojnë në emër të pronës komunale, të iu mundësohet bartja në emër të institucionit Këshilli i bashkësisë islame në Obiliq.

Kjo kërkesë i dërgohet për shqyrtim DPUKP-së, e cila duhet të sjellë një rekomandim në Kuvend.

4. Kërkesa nga Fanol Shala, Klubi aeronautik "Shqiponjat e Kastriotit" i cili kërkon blerjen e pajisjeve fluturuese të nevojshme për klubin në fjalë.

Kjo kërkesë i dërgohet për shqyrtim DKRS-së, e cila duhet të sjellë një rekomandim në Kuvend.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, me propozimet për emërtim të rrugëve. Pas mbledhjes do të ua përcjellim në email të gjitha kërkesat për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit komunal.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo kërkesë të dërgohet dhe të shqyrtohet në Kuvend, edhe ashtu Kuvendi e ka formuar një Komision për emërtimin e rrugëve të reja, për ndërrimin e emrave, prandaj debatojmë në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Gjithashtu, edhe ne jemi që kjo kërkesë të shkoj në Kuvend. Megjithatë, këto dokumente ka pasë mundësi me na i dërgue dhe neve. Dje ose pardje na erdhi Rregullorja që ka të bëjë me energjinë elektrike dhe nuk kishte pengue kurgjë me na dërgue edhe këtë me vonesë. Sigurisht se kjo sot nuk është marrë, por është marrë më heret.

**Kryesuesja** – Sqaron se kjo është marrë dje pas orës 16, për atë edhe sot pas mbledhjes do të ua përcjellim menjëherë gjithë materialin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e kërkesës të Komisionit të DPUKP-së.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** - Unë kam kërkesa të vazhdueshme prej qytetarëve, që iu intereson lidhur me subvencionimin e lehonave, me subvencionet të cilat para zgjedhjeve kanë dalë qoftë për sera, qoftë për diçka tjetër në lista ende nuk i kanë marrë ato të mira. Po ashtu, në fshatin Bakshi derdhen ujërat e zeza nga Bardhoshi në arat e tyre dhe afër shtëpive të tyre dhe për këtë kisha pasë dëshirë prej Drejtorisë, e cila e mbulon këtë fushës gjatë seancës me na dhënë përgjegje.

**Kryesuesja** – Besoj se në seancën e Kuvendit, Drejtoria e shëndetësisë do të na japë një përgjegje lidhur me subvencionimin e lehonave, që sigurisht se kanë qenë të vitit paraprak që kanë mbetë, por edhe të muajit janar e shkurt Nga përvoja që kam ju, e dini se është një datë e caktuar kur edhe mbyllet buxheti dhe më nuk kemi të drejtë me bë pagesa dhe e di se ka mbetë një numër i lehonave në obligime për vitin që vjen. Vonesa do të ketë pak, por besoj se ato do të subvencionohen

**Mbledhja përfundoi në ora 10:22'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

